



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**V E N D I M**  
**K.P.P. 332/2020**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.08.2020 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me objekt “Rehabilitim i ndricimit rrugor me sistemin LED”, me nr. REF-65897-07-19-2020, me fond limit 65,817,340 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

Anullimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Mag-Utilities” sh.p.k.  
Adresa: Rezidenca “Kodra e Diellit 2”, Tiranë.

**Autoriteti kontraktor:** Bashkia Kavajë  
Adresa: Bulevardi “Josif Budo”, Kavajë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga ankimuesi dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ankimuesi ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Ankimuesi ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektet e ankesës të ankimuesit.

### II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.07.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Rehabilitim i ndricimit rrugor me sistemin LED*”, me nr. REF-65897-07-19-2020, me fond limit 65,817,340 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.

II.2. Në datën 24.07.2020, operatori ekonomik ankimues “Mag-Utilities” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të tednerit, si dhe anulimin e procedurës së mësipërme të prokurimit, me argumentin si më poshtë vijon:

*“[...]Lidhur me procedurën e mesiperme të prokurimit, konstatojmë se janë hartuar kritere për kualifikim diskriminuese, të cilat ulin konkurrencën në prokurim, si dhe nuk i vendosin ofertuesit në kushte të barabarta konkurimi dhe vlerësimi. Sa më sipër, bazuar në nenin 63 të LPP, po ju percjellim për shqyrtim formularin standart të ankimit, si shkallë e pare ankimi.*

*Ne kriteret specifike për kualifikim, njesia e prokurimit ka kërkuar që, për punët e ngjashme, për obsionin b, kerkohet që vlera të jete jo me e madhe se dyfishi i vleres limit të kontrates që prokurohet. Nje percaktim i tille eshte diskriminues, konfuz, i cili nuk i vendos ofertuesit në*

*kushte te barabarta konkurimi dhe vleresimi pasi, edhe ne rast se paraqitet nje kontrate me vlere 1 leke, sjell si pasoje kualifikimin, nderkohe qe LPP parashikon per vlere te pakten sa dyfishi i vlere se kontrates qe prokurohet per kete rast.*

*Ne kriteret specifike per kualifikim eshte kerkuar qe shoqeria duhet te kete 35 punonjes te siguruar, nderkohe qe ky numer eshte i tejfryre dhe i paargumentuar, ne raport me volumin e punimeve qe kerkohet te realizohen, si dhe me zerat perkates te preventivit. Referuar rastit konkret, ju e keni shpallur pune publike, nderkohe qe nuk eshte objekt i tille, pasi eshte F .V., si dhe ky objekt realizohet edhe me 10 punonjes.*

*Ne kriteret specifike per kualifikim keni kerkuar qe shoqeria duhet te kete 1 inxhinier elektrik, nderkohe qe per rastin e BOE keni kerkuar ne raport me perqindjen plotesimin e ketij kriteri. Lutemi per kete kriter sqaroni se sa duhet te jete ndarja ne rastin e BOE, pasi ju vetem 1 keni kerkuar, sadoqofte perqindja e marre persiper ne kontraten e bashkepunimit.*

*Ne kriteret specifike per kualifikim njesia juaj e prokurimit ka kerkuar qe shoqeria duhet te kete 6 elektriciste, por nuk keni percaktuar se nga kush institucione/organe leshohet dokumentacioni i kerkuar nga ana juaj, kjo me qellim qe ofertuesit te vihen ne kushte te barabarta konkurimi dhe vleresimi.*

*Ne kriteret per kualifikim jane kerkuar edhe certifikatat ISO perkatese por, certifikime te tilla si 9001, 18001, 39001 ETJ NUK EGZISTOJNE, vetem sipas ketij percaktimi te bere nga njeisa e prokurimit. Gjithashtu rezulton se jane percaktuar edhe ISO te pavlefshme, te cilat ne daten e zhvillimit te procedures, nuk egzistojne si te tilla. Ne kete menyre, ofertuesit nuk vihen ne kushte te barabarta konkurimi dhe vleresimi.*

*Ne kriteret specifike per kualifikim keni kerkuar edhe mostrat e mallit, po keni harruar qe ne rastin konkret ju e keni klasifikuar procedure e prokurimit pune publike, pra jo FV malli, gje e cila eshte shume e gabuar. Pra, mostrat mund te kerkohen vetem ne rastin e procedures se prokurimit mall dhe jo per pune publike, ku nje kerkese e tille per rastin ne fjale, nuk gjen mbeshtetje ligjore. Gjithashtu, keni bere nje percaktim jo vetem antiligjor, por edhe shume te paqarte, ku nje here kerkoni te paraqitet mostra brenda 5 diteve nga kerkesa, nderkohe nuk e kuptojme se ne cilen periudhe duhet te paraqiten mostrat e pretenduara nga ana juaj, si dhe sqaroni mosparaqitja e deklarates. . . . Nderkohe qe nuk keni kerkuar asnje deklarate.*

*I nderuar titullar i AK.*

*Lidhur me proceduren e mesiperme te prokurimit konstatojme se, nga njesia juaj e prokurimit jane shkelur nenet 1, 2, 20, 46, te LPP, si dhe jane ngaterruar nenet 26 e 27 te LPP, pra eshte ngaterruar se cfare lloji procedure do te ndiqet nga ana juaj. Ne keto kushte, kerkojme modifikimin e kriterëve per kualifikim, bazuar ne nenet 46, 63 te LPP, si dhe vendosjen e tyre konform dispozitave ligjore dhe nenligjore ne fuqi. Megjithate, konstatojme se ne rastin konkret, duke qene se keni percaktuar kriteret per pune publike, anullimi i kesaj eshte i pashmangshem. Gjithashtu, nuk kuptojme kerkesa te tilla per kualifikim, referuar zerave qe kerkohet te realizohen, ku nuk po e kuptojme se per cilat rruge behet fjale konkretisht, se ku do te vendoset ndricimi qe ju kerkoni. Mos valle ..... sepse duam qe te bejme edhe vete verifikimin se ku do te*

*vendosen, qe te japim nje oferte sa me dinjitoze, pra duke ditur terrenin konkret. Duke ju uruar pune te mbare, mbetemi ne pritje te nje pergjigje sa me te shpejte, sipas afateve te parashikuara ne ligj, per te vazhduar me tej konform parashikimeve ligjore dhe nenligjore ne fuqi, si dhe prane instancave kompetente. [...]*

II.3. Referuar dokumentacionit të administruar pranë KPP, në funksion të hetimit administrativ për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, konstatohet se autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën, operatorit ekonomik ankimes “Mag-Utilities” sh.p.k., me anë të shkresës nr.3326/1prot., datë 28.07.2020, duke mos e pranuar atë, me arsyetimin si më poshtë vijon:

*[...]1. Ligji i Prokurimit Publik te cilit i referoheni, nuk percakton kushte te vecante te kerkesave per kualifikim. Referuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” SEKSIONI II “Informacione të veçanta për kontratat” Neni 26 “Kontratat për punë publike” në pikën 6 citohet “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.”. Si konkluzion, kerkesa per kualifikim e vendosur nga Autoriteti Kontraktor jo vetëm që nuk diskriminon, por favorizon pjesëmarrjen e operatoreve ekonomike.*

*2. Referuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” SEKSIONI II “Informacione të veçanta për kontratat” Neni 26 “Kontratat për punë publike” në pikën 5 citohet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.” Kërkesa per dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit për mesatarisht 35 (tridhjetë e pesë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, manovratorë, staf teknik) eshte e mireargumentuar nga Autoritetit Kontraktor dhe llogaritur sakte duke marre ne konsiderate orët e punës qe duhet per realizimin e secilit ze punimesh referuar analizës teknike të çmimeve dhe VKM 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, LIGJ Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punes i Republikës së Shqipërisë” neni 83 “Kohëzgjatja maksimale javore e punës” dhe afatin maksimal për realizimin e kontrates. Pretendimi juaj se kerkesa per numrin e punetoreve te nevojshem per realizimin e kontrates eshte i pabazuar. Pretendimi juaj se objekti i kontrates realizohet me 10 punonjes eshte i paargumentuar.*

*Perzgjedhja e llojit te procedures eshte e drejte e Autoritetit Kontraktor referuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 60 “Urdhri i Prokurimit” citon “Kur ka nevojë për punë/mallra/shërbime, pas përllogaritjes së fondit limit sipas nenit 59 të këtyre rregullave, titullari i autoritetit kontraktor apo zyrtari i autorizuar nxjerr menjëherë urdhrin e prokurimit”. Në nenin 59 “Përllogaritja e vlerës limit të kontratës” ne piken 2 citohet “Në përllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga*

*Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse”. Ne rastin konkret preventivi i është hartuar ne baze të VKM 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.*

*3. Ne kërkesat për kualifikim pika 2.3.4.1 citohet “Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, librezë pune, CV dhe certifikatë për 1 (një) inxhinier elektrik, i cili duhet të figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”. Kërkesat e këtij kriteri janë minimale dhe nuk i referohen vetëm përqindjes së pjesëmarrjes së anëtarëve të një bashkimi operatorësh por edhe elementeve konkrete të percaktuara në kontratën e bashkëpunimit.*

*4. Ne kërkesat për kualifikim pika 2.3.4.2 citohet “Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesi pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/ diploma/ certifikata trajnimi për minimumi 6 (gjashtë) elektrikistë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Autoriteti kontraktor ka parashikuar se operatorët ekonomikë për të përmbushur këtë kriter mund ta vertetojnë me me shume se një dokument specifik, sic pretendoni ju. Kjo krijon mundësi pjesëmarrje më të madhe të operatorëve ekonomik dhe rrit konkurrencën.*

*5. Pavarësisht llojit të procedurës, është e drejtë e autoritetit kontraktor të kërkojë vërtetësinë e fakteve (mostrave) të cilat garantojnë realizimin e kontratës konform specifikimeve teknike për vetë faktin që investimi ka një rëndësi të vecantë ekonomike dhe që të garantojë ruajtjen e arkitekturës ekzistuese. [...]”*

II.4.Në datën 04.08.2020, operatori ekonomik ankimues “Mag-Utilities” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

*“[...]Lidhur me përgjigjen e dorezuar nga Autoriteti Kontraktor, konstatojmë se ky autoritet nuk ka kthyer përgjigje mbi të gjitha pikat për sa kompania jone është ankuar pranë Bashkisë Kavaje. Përgjigje ky autoritet ka kthyer vetëm për 4 pika, për të cilat ka vendosur mospranimin e tyre. Në kushtet e mesipërme, kur AK nuk ka kthyer përgjigje për të gjitha pikat për sa trajtohen në ankese, atëherë pranon për sa është trajtuar. Sa me sipër, bazuar në nenin 63 të LPP, kundërshtojmë pranë KPP, si institucioni me i lart në fushën e prokurimeve, si me poshtë vijon:*

*Ne kriteret specifike për kualifikim, njesia e prokurimit ka kërkuar që, për punët e ngjashme, për obsionin b. kerkohet që vlera të jete jo me e madhe se dyfishi i vleres limit të kontrates që prokurohet. Nje percaktim i tille eshte diskriminues, konfuz, i cili nuk i vendos ofertuesit ne kushte te barabarta konkurimi dhe vleresimi pasi, edhe ne rast se paraqitet nje kontrate me vlerë 1 leke, sjell si pasoje kualifikimin, nderkohe që LPP parashikon për vlera të pakten sa dyfishi i*

*vleres se kontrates qe prokurohet per kete rast. Ne kthimin e pergjigjes, AK citon vetem ligjin, por nuk e kupton se ka hartuar nje kerkese konfuze, e cila nuk i ve ofertuesit ne kushte te barabarta konkurimi dhe vleresimi sepse, kur kerkohet jo me e madhe se dyfishi, atehere mund te kualifikohesh edhe per vlere kontrate 1 leke, ashtu edhe per vlera me te medha. Sqarimi i AK qe nje kerkese e tille nxit konkurrencen, nuk gjen mbeshetje ligjore, pasi bie ne kundershtrim me LPP dhe DST ku parashikohet per te pakten dyfishi.*

*Ne kriteret specifike per kualifikim eshte kerkuar qe shoqeria duhet te kete 35 punonjes te siguruar, nderkohe qe ky numer eshte i tejfryre dhe i paargumentuar, ne raport me volumin e punimeve qe kerkohet te realizohen, si dhe me zerat perkates te preventivit. Referuar rastit konkret, AK e ka shpallur pune publike, nderkohe qe nuk eshte objekt i tille, pasi eshte F.V. si dhe ky objekt realizohet edhe me 10 punonjes. Ne pergjigjen e AK jepen sqarime te pakuptipmta, duke cituar referenca ligjore e nenligjore, por AK nuk e kupton se duhej te jepte nje pergjigje teknike, ku te argumentonte teknikisht perse duhen 35 punonjes, nderkohe qe ky objekt realizohet edhe me vetem 10 punonjes.*

*Lidhur me ankesen qe AK e shpallur pune publike nderkohe qe nuk eshte objekt i tille pasi eshte F.V. Bashkia Kavaje nuk ka kthyer asnje pergjigje, duke e pranuar kete fakt. Nisur edhe vetem nga ky fakt, kjo procedure prokurimi duhej anuluar dhe rishpallur nga e para per tenderin F.V.*

*Ne kriteret specifike per kualifikim, AK ka kerkuar qe shoqeria duhet te kete 1 inxhinier elektrik, nderkohe qe per rastin e BOE ka kerkuar ne raport me perqindjen plotesimin e ketij kriteri. Lutemi per kete kriter sqaroni se sa duhet te jete ndarja ne rastin e BOE, pasi ju vetem 1 keni kerkuar, sadoqofte perqindja e marre persiper ne kontraten e bashkepunimit. Ne pergjigjen e derguar AK jep vetem referencen ligjore, por pa dhene sqarimin ligjor mbi plotesimin e kesaj kerkese, ne rastin e BOE, pasi edhe ne preventivin qe ata kane publikuar, nuk mund te behet dot ndarja e ketij kriteri ne rastin e BOE, pasi nuk ka element te tille ne preventiv.*

*Ne kriteret specifike per kualifikim njesia e prokurimit ka kerkuar qe shoqeria duhet te kete 6 elektriciste, por nuk keni percaktuar se nga kush institucione/organe leshohet dokumentacioni i kerkuar nga ana e AK, kjo me qellim qe ofertuesit te vihen ne kushte te barabarta konkurimi dhe vleresimi. Ne pergjigjen e derguar, nuk jepet asnje sqarim ligjor, i cili mbase nuk kuptohet nga AK Bashkia Kavaje, ne kundershtrim te plote kjo per sa APP ka dhene sqarime dhe vendime per raste te tilla analoge.*

*Ne kriteret per kualifikim jane kerkuar edhe certifikatat ISO perkatese por, certifikime te tilla si 9001, 18001, 39001 ETJ NUK EGZISTOJNE, vetem sipas ketij percaktimi te bere nga njesia e prokurimit. Gjithashtu rezulton se jane percaktuar edhe ISO te pavlefshme, te cilat ne daten e zhvillimit te procedures, nuk egzistojne si te tilla. Ne kete menyre, ofertuesit nuk vihen ne kushte te barabarta konkurimi dhe vleresimi. Lidhur me kete pike ankimi, AK nuk ka dhene asnje pergjigje pasi mbase nuk e kupton nje pike te tille.*

*Ne kriteret specifike per kualifikim AK ka kerkuar edhe mostrat e mallit, po ka harruar qe ne rastin konkret ju e keni klasifikuar procedure e prokurimit pune publike, pra jo FV malli, gje e cila eshte shume e gabuar. Pra, mostrat mund te kerkohen vetem ne rastin e procedures se*

*prokurimit mall dhe jo per pune publike, ku nje kerkese e tille per rastin ne fjale, nuk gjen mbeshtetje ligjore. Lidhur me kete pike ankimi, e cila mbase nuk kuptohet nga anetaret e komisionit te shqyrtimit te ankeses, nuk eshte kthyer pergjigje, duke pranuar per sa eshte trajtuar. AK nuk kupton mbase se ku ndryshon F.V. per blerje malli me procedure pune publike, te cilat kane DST te ndryshme, per rrjedhoje edhe kriteret e ndryshme per kualifikim. Gjithashtu, AK ka bere nje percaktim jo vetem antiligjor, por edhe shume te paqarte, ku nje here kerkoni te paraqitet mostra brenda 5 diteve nga kerkesa, nderkohe nuk e kuptojme se ne cilen periodhe duhet te paraqiten mostrat e pretenduara nga ana AK, si dhe sqaroni mosparaqitja e deklarates. Nderkohe qe nuk keni kerkuar asnje deklarate. Lidhur me kete pike konfuze per kualifikim, AK nuk ka kthyer asnje pergjigje, pasi mbase nuk e kupton shkeljen e ligjit qe ka kryer. Nje here kerkon deklarate, nderkohe ne kerkesat per kualifikim nuk kerkon asnje deklarate. Nje here kerkon brenda 5 diteve nga kerkesa, nderkohe nuk kuptohet kush do te jete kerkesa etj.*

*Lidhur me proceduren e mesiperme te prokurimit konstatojme se, nga njesia juaj e prokurimit jane shkelur nenet 1, 2, 20, 46, te LPP, si dhe jane ngaterruar nenet 26 e 27 te LPP, pra eshte ngaterruar se cfare lloji procedure do te ndiqet nga ana juaj. Nderkohe AK nuk ka dhene asnje pergjigje lidhur me kete pike. Ne keto kushte, kerkojme modifikimin e kriterëve per kualifikim, bazuar ne nenet 46, 63 te LPP, si dhe vendosjen e tyre konform dispozitave ligjore dhe nenligjore ne fuqi, kerkese e cila nuk eshte pranuar nga AK. Megjithate, konstatojme se ne rastin konkret, duke qene se keni percaktuar kriteret per pune publike, anullimi i kesaj eshte i pashmangshem. Lidhur me kete pike per kualifikim, AK nuk ka dhene asnje pergjigje, pasi anullimi i procedures eshte i pashmangshem. Gjithashtu, nuk kuptojme kerkesa te tilla per kualifikim, referuar zerave qe kerkohet te realizohen, ku nuk po e kuptojme se per cilat rruge behet fjale konkretisht, se ku do te vendoset ndricimi qe ju kerkoni, sepse duam qe te bejme edhe vete verifikimin se ku do te vendosen, qe te japim nje oferte sa me dinjitoze, pra duke ditur terrenin konkret.[...]*”

II.5. Në datën 13.08.2020, nëpërmjet shkresës me nr.3326/3prot., datë 11.08.2020, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimes.

### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, informacionit dhe dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Mag-Utilities” sh.p.k. për anullimin e procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Lidhur me proceduren e mesiperme te prokurimit konstatojme se, nga njesia juaj e prokurimit jane shkelur nenet 1, 2, 20, 46, te LPP, si dhe jane ngaterruar nenet 26 e 27 te LPP, pra eshte ngaterruar se cfare lloji procedure do te ndiqet nga ana juaj. Nderkohe AK nuk ka dhene asnje pergjigje lidhur

me kete pike. Ne keto kushte, kerkojme modifikimin e kriterëve per kualifikim, bazuar ne nenet 46, 63 te LPP, si dhe vendosjen e tyre konform dispozitave ligjore dhe nenligjore ne fuqi, kerkese e cila nuk eshte pranuar nga AK. Megjithate, konstatojme se ne rastin konkret, duke qene se keni percaktuar kriterë per pune publike, anullimi i kesaj eshte i pashmangshem. Lidhur me kete pike per kualifikim, AK nuk ka dhene asnje pergjigje, pasi anullimi i procedures eshte i pashmangshem.[...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në “Njoftimin e kontratës” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, është përcaktuar si vijon:

2.2 Lloji i “Kontratave për punë publike”

Realizimi i punëve

Projektimi dhe realizimi i punëve

X

III.1.2. Në shtojcën “Preventiv”, të ngarkuar në SPE për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

Nr	Analiza	Pershkrimi i materialeve	Njesia	Sasia	Çmimi	Vlera
1	An	F.V Ndrichues Led 100W, 5000K, 17000lm	cope	1,260		
2	An	F.V Ndrichues Led 70W, 5000K, 11900lm	cope	1,000		
3	An	F.V Njesi ndricimi Led 100W	cope	450		
4	An	F.V Njesi ndricimi Led 70W	cope	500		
5	An	F.V Njesi ndricimi Led 50W	cope	140		
6	An	F.V Shtylle ndricimi H=9m dekorative cilindrike me dy nivele D1 130mm D2 90mm e zinguar dhe e lyster me boje elektrostatische ne temperature 200*	cope	19		
7	An	F.V shtylla metalike dekorative per ndricim, H=7m, cilindrike me dy nivele D1 130mm, D2 90mm e zinguar dhe e lyster me boje elektrostatische ne temperature 200*	cope	61		
8	3.An/ksh	FV krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	cope	600		
9	An	F.V.kabell FG7OR 0,6/1kv 4x6mm2	ml	2,200		
10	An	F.V.kabell FG7OR 0,6/1kv 4x4mm2	ml	2,000		
11	An	F.V.kabell FG7OR 0,6/1kv 4x2,5mm2	ml	3,000		
12	An	F.V.kabell FG7OR 0,6/1kv 4x1,5mm2	ml	460		
13	An	F.V Puseta plastike 30x30	cope	200		
14	An	F.V Kapak,morsete,siguresse	cope	480		
15	3.An/et	FV elektroda tokezimi te zinguara 50x3mm L=150cm	cope	400		
16	An	F.V Kabell AL 4x16mm2	ml	9,500		
17	3.An/57	F.V.Sistem komandimi me rele muzgu per ndricim zonash te vecanta, ura etj.	cope	50		
					Vlera pa tvsh	-
					Tvsh 20%	-
					Shuma Totale	-

III.1.3. Në shtojcën “Specifikime teknike”, të ngarkuar në SPE për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

“Vitet e fundit, Bashkia Kavajë, ka investuar për të dhënë qytetit ndricim sa më të mirë në cilësi dhe vizualisht bashkohor. Me arritjet fundit të teknologjisë dhe rritjen e efikasitetit në shfrytëzimin e energjisë elektrike shihet si domosdoshmëri zëvendësimi i llambës tradicionale me atë LED. Për të ruajtur stilin dekorativ të qytetit, për të cilin është investuar për vite me



rradhe, qëllimi I këtij projekti është zëvendësimi vetëm I llampës apo I skedës së ndricuesit në presën dominuese të qytetit. Edhe në ato rrugë në të cilat do instalohen ndricues të rinj, kërkesa është të ruhet e njëjta linjë apo skedë si në ndricuesit që do të modifikohen. Të dhënat teknike të artikujve kryesorë janë si më poshtë:

1. Ndricues rrugor Led me xham te temperuar dhe guarnicion siliconi. I ndertuar ne alumin te stampuar nen presion dhe i lyster me boje elektrostatische. Diametri i fiksimit me shtyllen  $D=60$  mm. Burimi I drites SMD (Surface Mounted Device) , Fuqia elektrike 100ë, Kendi I perhapjes se drites  $155^\circ$ , Temperatura e nrgjyres 5000K, Fluksi I drites 17000 lm 170lm/Ëatt , Temperatura e punes  $T (-25/50^\circ\text{C})$ , Tensioni I punes  $U_i= 220V f= 50\text{hz}$  , CRI  $>70$ , Faktori i fuqise  $\text{Cos}\Theta=0.9$  , Shkalla e izolacionit per grupin optik IP 67, IK 08

2. Ndricues rrugor Led me xham te temperuar dhe guarnicion siliconi. I ndertuar ne alumin te stampuar nen presion dhe i lyster me boje elektrostatische. Diametri i fiksimit me shtyllen  $D=48\text{mm}$ . Burimi I drites SMD (Surface Mounted Device), Fuqia elektrike  $P=70\text{ë}$ , KENDI I PERHAPJES SE DRITES  $155^\circ$ , Temperatura e nrgjyres 5000K, Fluksi I drites 11900 lm 170lm/Ëatt, Temperatura e punes  $T (-25/50^\circ\text{C})$  , Tensioni I punes  $U_i= 220V f=50\text{hz}$ , CRI  $>80$ , Faktori i fuqise  $\text{Cos}\Theta=0.9$ , Shkalla e izolacionit per grupin optik IP67, IK 08.

3. Ndricues rrugor Led me xham te temperuar dhe guarnicion siliconi. I ndertuar ne alumin te stampuar nen presion dhe i lyster me boje elektrostatische. Burimi I drites SMD (Surface Mounted Device), Lente asometrike Fuqia elektrike  $P=100\text{ë}$ , Kendi i perhapjes se drites  $160^\circ$ , Temperatura e nrgjyres 5000K, Fluksi I drites 17000 lm 170lm/Ëatt, Temperatura e punes  $T (-25/50^\circ\text{C})$ , Tensioni I punes  $U_i= 220V f=50\text{hz}$ , CRI  $>80$  , Faktori i fuqise  $\text{Cos}\Theta=0.9$  , Shkalla e izolacionit per grupin optik IP67, IK 08.

4. Ndricues rrugor Led me xham te temperuar dhe guarnicion siliconi. I ndertuar ne alumin te stampuar nen presion dhe i lyster me boje elektrostatische. Burimi I drites SMD (Surface Mounted Device), Fuqia elektrike  $P=70\text{ë}$ , Kendi i perhapjes se drites  $155^\circ$ , Temperatura e nrgjyres 5000K, Fluksi I drites 11900 lm 170lm/Ëatt, Temperatura e punes  $T (-25/50^\circ\text{C})$ , Tensioni I punes  $U_i= 220V f=50\text{hz}$ , CRI  $>80$ ,  $\text{Cos}\Theta=0.9$  IP67, IK 08.

5. Ndricues rrugor Led me xham te temperuar dhe guarnicion siliconi. I ndertuar ne alumin te stampuar nen presion dhe i lyster me boje elektrostatische. Burimi I drites SMD (Surface Mounted Device), Fuqia elektrike  $P=50\text{ë}$ , Kendi i perhapjes se drites  $155^\circ$ , Temperatura e nrgjyres 6000K, Fluksi I drites 8500 lm 170lm/Ëatt , Temperatura e punes  $T (-25/50^\circ\text{C})$ , Tensioni I punes  $U_i= 220V f=50\text{hz}$ , CRI  $>80$ , Faktori i fuqise  $\text{Cos}\Theta=0.9$ , Shkalla e izolacionit per grupin optik IP 67, IK 08.

6. Shtylle ndricimi  $H=9\text{m}$  dekorative cilindrike me dy nivele  $D1=130\text{mm}$  dhe  $D2=90\text{mm}$  e zinguar dhe e lyster me boje elektrostatische ne temperaturen  $200^\circ\text{C}$ .

7. Shtylle ndricimi  $H=7\text{m}$  dekorative cilindrike me dy nivele  $D1=130\text{mm}$  dhe  $D2=90\text{mm}$  e zinguar dhe e lyster me boje elektrostatische ne temperaturen  $200^\circ\text{C}$ .

8. Krah metalik I zinguar dhe I lyster me boje elektrostatische ne temperature  $200^\circ$  Celsius me dy fasheta per tru vendosur ne shtylla betoni.

Rehabilitimi i ndricimit rrugor me sistemin LED do te gjej zbatim ne te gjithë territorin e Bashkise Kavaje (qyteti Kavaje, fshati Synej, fshati Luz I Vogel, fshati Golem, fshati Helmas) ne te gjitha rruget dhe sheshet sipas planvendosjes perkatese.”

III.1.4. Në nenin 3, pika 6 dhe 8 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se:

“6. “Kontrata publike furnizimi” janë kontratat publike, që kanë objekt blerjen, blerjen me pjesë ose me këste, qiranë me ose pa mundësi blerjeje të mallrave. Një kontratë publike, që ka objekt furnizimin me mallra dhe që përfshin në mënyrë dytësore edhe vendosjen dhe instalimin, vlerësohet si “kontratë publike furnizimi”, nëse vlera e mallrave e tejkalon vlerën e vendosjes apo instalimit.

8. “Kontratat për punë publike” janë kontratat publike, që kanë objekt realizimin, projektimin dhe realizimin e punimeve apo të punës ose realizimin me çfarëdo mjeti të një pune, që përputhet me kërkesat e përcaktura nga autoriteti kontraktor.”

III.1.5. Në nenin 26 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këëshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se:

“-Në dokumentet e tenderit për kontratat e punëve publike, projekti duhet të plotësohet me hollësi, duke dhënë çmimet për njësi, vëllimin dhe llojet e punëve.

-Punët publike mund të prokurohen:

-me anë të punimeve me matje në bazë të çmimeve fikse, në rastet kur vëllimi i punëve të specifikuara në projekt mund të ndryshojë gjatë realizimit. Në këtë rast, kontraktori është i detyruar të ruajë, pa asnjë ndryshim çmimet për njësi të përcaktuara në ofertën e dorëzuar.

Kur punët prokurohen me anë të punimeve me matje, vëllimi i punëve jepet me hollësi dhe përmban të gjitha çmimet dhe përqindjet që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme (si për shembull: fondi rezervë, të ardhurat minimale, shpenzimet minimale).

-me kontratë me çelësa në dorë, ku vëllimi i punëve i parashikuar në projekt, mund të shërbejë vetëm si një orientim dhe ofertuesi kryen një studim të hollësishëm të projektit, pa asnjë detyrim për të respektuar vëllimin e punëve të projektit.

-Në këtë rast kontraktori ka përgjegjësinë e realizimit të punëve, pa kërkuar asnjë fond shtesë, përveç vlerës së kontratës së prokurimit, që në çdo rast, përfshin të gjitha detyrimet fiskale në fuqi.

-Specifikimet teknike shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës.

-Autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit parashikon me grafik, fazat dhe afatet e realizimit të punëve.”

III.1.6. Referuar specifikimeve teknike dhe preventivit të procedurës objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, autoriteti kontraktor ka parashikuar në preventiv, rehabilitimin e ndricimit rrugor, ku në pjesën më të madhe të preventivit ka përcaktuar se do të kryhet zëvendësimi vetëm i llambave ose skedave të ndricuesve egzistues me teknologjinë LED, nëpërmjet furnizimit dhe vendosjes të pajisjeve dhe aksesorëve përkatës, si dhe do të do të kryhet furnizimi dhe vendosja e disa shtyllave të ndricimit (komplet). Pra objekti i prokurimit rezulton një procedurë, e cila përmban në vetvete furnizimin me ndricues të rinj të shtyllave egzistuese dhe furnizimin me shtylla të reja ndricimi, si dhe shërbimin/punën për vendosjen e tyre. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, për sa kohë nga proceset e mësipërme, vlera e blerjes së ndricuesve dhe shtyllave të ndricimit është më e madhe se vlera e shërbimit/punës që do të kryhet, atëherë autoriteti kontraktor duhet ta konsideronte procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi kontratë

furnizimi mallrash në përputhje me nenin 3, pika 6 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, pavarësisht se këto të fundit konsiderohen materiale ndërtimi dhe janë të përfshira në manualin e miratuar me VKM nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit, pasi duhet të ripublikojë procedurën e prokurimit duke përdorur dokumentat standarte të tenderit të cilat janë të miratuara posacërisht për kontratat e mallrave, si dhe duhet të rihartojë kriteret e kualifikimit në përputhje me nenin 27 “Kontrata e Mallrave” të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilities” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Ne kriteret specifike per kualifikim, njesia e prokurimit ka kerkuar qe, per punet e ngjashme, per obsionin b. kerkohet qe vlera te jete jo me e madhe se dyfishi i vleres limit te kontrates qe prokurohet. Nje percaktim i tille eshte diskriminues, konfuz, i cili nuk i vendos ofertuesit ne kushte te barabarta konkurimi dhe vleresimi pasi, edhe ne rast se paraqitet nje kontrate me vlere 1 leke, sjell si pasoje kualifikimin, nderkohe qe LPP parashikon per vlera te pakten sa dyfishi i vleres se kontrates qe prokurohet per kete rast. Ne kthimin e pergjigjes, AK citon vetem ligjin, por nuk e kupton se ka hartuar nje kerkese konfuze, e cila nuk i ve ofertuesit ne kushte te barabarta konkurimi dhe vleresimi sepse, kur kerkohet jo me e madhe se dyfishi, atehere mund te kualifikohesh edhe per vlere kontrate 1 leke, ashtu edhe per vlera me te medha. Sqarimi i AK qe nje kerkese e tille nxit konkurrencen, nuk gjen mbeshtetje ligjore, pasi bie ne kundërshtim me LPP dhe DST ku parashikohet per te pakten dyfishi. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën nr.12, pika 2.3.1 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon:

“2.3.1.Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon:

a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Për të provuar këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

– Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqitet formulari i vleresimit, kontrata, situacioni përfundimtar dhe situacionet progresive/pjesore, akti i kolaudimit, çertifikatën e marrjes në dorëzim dhe faturat tatimore përkatëse. Në rast se kontrata e ngjashme është lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqitet edhe kontrata e bashkëpunimit midis tyre.

– Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqitet formulari i vleresimit, kontrata, situacioni përfundimtar, akti i kolaudimit, çertifikatën e marrjes në dorëzim dhe faturat tatimore përkatëse. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

*b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë tri viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.*

*– Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin publik të paraqitet formulari i vleresimit, kontratat, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit, çertifikatat e marrjes në dorëzim dhe faturat tatimore përkatëse për secilën kontratë. Në rast se kontratat e ngjashme janë lidhur nga një bashkim operatorësh ekonomikë duhet të paraqiten edhe kontratat e bashkëpunimit midis tyre.*

*– Ne rastin e kontratave të ngjashme me sektorin privat të paraqitet formulari i vleresimit, kontratat, situacionet përfundimtare, aktet e kolaudimit dhe çertifikatat e marrjes në dorëzim dhe faturat tatimore përkatëse për secilën kontratë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementet konkrete) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.*

*Plotësimi i njërit prej dy kushteve “a” ose “b” e bën ofertën të kualifikueshme.”*

III.2.2. Në pikën 4 të nenit 27 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.”*

III.2.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues, Komisioni thekson se, bazuar në argumentimet e parashtruara në pikën III.1.6 të këtij vendimi, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë tërësisht këtë kriter duke e hartuar sipas përcaktimeve në pikën 4 të nenit 27 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Në këto kushte, për sa kohë kriteri mbi eksperiencën e ngjashme do të modifikohet, si pasojë e mospërputhshmërisë me nenin 27 të aktit nënligjor të sipërcituar, Komisioni gjykon se nuk egziston më objekt ankimi lidhur me këtë pikë, e për rrjedhojë pretendimi i ankimuesit nuk do të merret në shqyrtim.

III.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilities” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: *“[...]Ne kriteret specifike per kualifikim eshte kerkuar qe shoqeria duhet te kete 35 punonjes te siguruar, nderkohe qe ky numer eshte i tejfryre dhe i paargumentuar, ne raport me volumin e punimeve qe kerkohet te realizohen, si dhe me zerat perkates te preventivit. Referuar rasti konkret, AK e ka shpallur pune publike, nderkohe qe nuk eshte obiekt i tille, pasi eshte F.V. si dhe kv objekt realizohet edhe me 10 punonjes. Ne pergjigjen e AK jepen sqarime te pakuptipmta, duke cituar referenca ligjore e nenligjore, por AK nuk e kupton se duhej te jepte nje pergjigje teknike, ku te argumentonte teknikisht perse duhen 35 punonjes, nderkohe qe ky objekt realizohet edhe me vetem 10 punonjes [...]”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën nr.12, pika 2.3.3 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon::

“2.3.3.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

– Vërtetim për fuqinë mesatare punëtore për mesatarisht 35 (tridhjetë e pesë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, manovratorë, stafi teknik) për periudhën Janar 2020 – Qershor 2020, i lëshuar nga Administrata Tatimore.

– Listëpagesat për periudhën Janar 2020 – Qershor 2020, sipas formatit të miratuar nga Administrata Tatimore.”

III.3.2. Me anë të shkresës nr.3326/3prot., datë 11.08.2020, të administruar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor ka informuar Komisionin si më poshtë vijon:

“Referuar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” SEKSIONI II “Informacione të veçanta për kontratat” Neni 26 “Kontratat për punë publike” në pikën 5 citohet “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.” Kërkesa për dëshmi për fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit për mesatarisht 35 (tridhjetë e pesë) punonjës (përfshirë në këtë numër punëtorë, manovratorë, staf teknik) është e mireargumentuar nga Autoritetit Kontraktor dhe llogaritur sakte duke marrë në konsideratë orët e punës që duhet për realizimin e secilit ze punimesh referuar analizës teknike të cmimeve dhe VKM 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, LIGJ Nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” neni 83 “Kohëzgjatja maksimale javore e punës” dhe afatin maksimal për realizimin e kontratës.

Nr	Analiza	Pershkrimi	Njesia	Sasia	Ore pune / njesi	Ore pune gjithsej	Punetore ne dite
1	2	3	4	5	6	7=5*6	8=(shenim)
1	An	F.V Ndriçues Led 100W	cope	1,260	2	2520	7.16
2	An	F.V Ndriçues Led 70W	cope	1,000	2	2000	5.68
3	An	F.V Njesi ndriçimi Led 100W	cope	450	2	900	2.56
4	An	F.V Njesi ndriçimi Led 70W	cope	500	2	1000	2.84
5	An	F.V Njesi ndriçimi Led 50W	cope	140	2	280	0.80
6	An	F.V Shtylle ndriçimi H=9m dekorative cilindrike me dy nivele D1 130mm D2 90mm e zinguar dhe e lyster me boje elektrostatische ne temperature 200*	cope	19	1.8	34.2	0.10
7	An	F.V shtylla metalike dekorative per ndriçim, H=7m, cilindrike me dy nivele D1 130mm, D2 90mm e zinguar dhe e lyster me boje elektrostatische ne temperature 200*	cope	61	1.8	109.8	0.31
8	3.An/ksh	FV krah shtylla metalike KRH - MSI 1500/1500/10	cope	600	1.2	720	2.05
9	An	F.V.kabell FG7OR 0,6/1kv 4x6mm2	ml	2,200	0.1	220	0.63
10	An	F.V.kabell FG7OR 0,6/1kv 4x4mm2	ml	2,000	0.1	200	0.57

11	An	F.V.kabell FG7OR 0,6/1kv 4x2,5mm2	ml	3,000	0.1	300	0.85
12	An	F.V.kabell FG7OR 0,6/1kv 4x1,5mm2	ml	460	0.1	46	0.13
13	An	F.V Puseta plastike 30x30	cope	200	0.4	80	0.23
14	An	F.V Kapak,morsete,sigurese	cope	480	0.1	48	0.14
15	3.An/et	FV elektroda tokezimi te xinguara 50x3mm L=150cm	cope	400	0.4	160	0.45
16	An	F.V Kabell AL 4x16mm2	ml	9,500	0.2	1900	5.40
17	3.An/57	F.V.Sistem komandimi me rele muzgu per ndricim zonash te vecanta, ura etj.	cope	50	8	400	1.14
							<b>31.02</b>
<b>Shenim:</b> 8 = 7 (ore pune gjithsej / 44 dite(afati I punimeve) / 8 (ore pune ne dite)							

III.3.3. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

III.3.4. Në interpretim literal të bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni vlerëson se, kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën, si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në rastin konkretë, referuar preventivit të procedurës së prokurimit, afatit të ekzekutimit të kontratës, si dhe analizës të kryer nga vetë autoriteti kontraktor, Komisioni gjykon se kriteri për disponimin nëpërmjet vërtetimit nga administrata tatimore, të një numri mesatar prej 35 punonjësish, është i ekzagjeruar dhe i pajustificuar, pasi një numër i tillë punonjësish është joproportional me objektin e prokurimit, si dhe nuk përputhet as me analizën e kryer nga vetë autoriteti kontraktor. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve, por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi i saj. Komisioni vlerëson se, kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej 35 punonjësish, si dhe duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë zbatimin e kontratës, si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi, do të penalizohen vetëm për faktin se nuk përmbushin numrin e kërkuar të punonjësve, i cili në rastin konkret është i ekzagjeruar. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke e ulur numrin mesatar të punonjësve të në përputhje me volumin e kontratës që prokurohet.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues *“Ne kriteret specifike për kualifikim, AK ka kërkuar që shoqëria duhet të ketë 1 inxhinier elektrik, nderkohe që për rastin e BOE ka kërkuar në raport me përqindjen plotësimin e këtij kriteri. Lutemi për këto kriter sqaroni se sa duhet të jete ndarja në rastin e BOE, pasi ju vetem 1 keni kërkuar, sadoqofte përqindja e marre persiper në kontratën e bashkëpunimit. Ne pergjigjen e derguar AK jep vetem referencen*

ligjore, por pa dhene sqarimin ligjor mbi plotesimin e kesaj kerkese, ne rastin e BOE, pasi edhe ne preventivin qe ata kane publikuar, nuk mund te behet dot ndarja e ketij kriteri ne rastin e BOE, pasi nuk ka element te tille ne preventiv”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret ndodhemi para kërkimit për sqarime mbi kriteret e kualifikimit. Në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteri kualifikues është në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës), por në thelb është një paqartësi mbi kërkesën e autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik në ankesë ka theksuar paqartësinë në përmbushjen e tyre dhe ka parashtruar pyetje. Gjithashtu, KPP konstaton se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 42 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktor, në çdo kohë, përpara mbarimit të afatit të fundit për dorëzimin e ofertave dhe për çfarëdolloj arsyeje, me nismën e vet ose me kërkesë për sqarim nga një operator ekonomik, mund të bëjë ndryshime në dokumentet e tenderit, përmes hartimit të një shtojce. Çdo shtojcë u komunikohet menjëherë të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit dhe bëhet detyruese për ta. Shtojca vihet në dispozicion edhe në rrugë elektronike. 2/1. Në çdo rast, kur ndryshohen dokumentet e tenderit, autoriteti kontraktor zgjat afatin kohor për dorëzimin e ofertës me 5 ditë, ndërsa për prokurimet mbi kufijtë e lartë monetarë me 10 ditë.”*, ka dhënë sqarimet e duhura për operatorin ekonomik ankimues me anë të shkresës nr.3326/1prot., datë 28.07.2020, lidhur me kriterin e vecantë të kualifikimit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, “[...]3. Ne kërkesat per kualifikim pika 2.3.4.1 citohet “Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune, diplomë, librezë pune, CV dhe çertifikatë për 1 (një) inxhinier elektrik, i cili duhet të figurojë në licensën e shoqërisë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”. Kërkesat e ketij kriteri jane minimale dhe nuk i referohen vetem përqindjes se pjesëmarrjes se anetareve te nje bashkimi operatoresh por edhe elementeve konkrete te percaktuara ne kontraten e bashkepunimit.[...], por këtë sqarim në zbatim të nenit 42 pika 2 të L.P.P-së, autoriteti kontraktor nuk e ka publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të publikojë këtë sqarim, sikurse përcaktohet në nenin 42 pika 2 të L.P.P-së.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.5. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilities” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Ne kriteret specifike per kualifikim njesia e prokurimit ka kerkuar qe shoqeria duhet te kete 6 elektriciste, por nuk keni percaktuar se nga kush institucione/organe leshohet dokumentacioni i kerkuar nga ana e AK, kjo me qellim qe ofertuesit te vihen ne kushte te

*barabarta konkurimi dhe vleresimi. Ne pergjigjen e derguar, nuk jepet asnje sqarim ligjor, i cili mbase nuk kuptohet nga AK Bashkia Kavaje, ne kundërshtim te plote kjo per sa APP ka dhene sqarime dhe vendime per raste te tilla analoge. [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.5.1. Në shtojcën nr.12, pika 2.3.4.2 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon::

*“Për të përmbushur këtë kapacitet operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë Autoritetit Kontraktor kontratë të vlefshme pune dhe dëshmi të kualifikimit profesional/ diploma/ certifikata trajnimi për minimumi 6 (gjashtë) elektrikistë. Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit, në raport me përqindjen (elementët konkretë) e pjesëmarrjes së tyre në bashkim”*

III.5.2. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 27/3 të VKM 914/2014 përcakohet se: *“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

III.5.3. Sa më sipër, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtë për drejtë me kriterin e vecantë të vendosur. Lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e 6 (gjashtë) elektrikistëve të pajisur dëshmi të kualifikimit profesional/diploma/certifikata trajnimi, konstatojmë se në formulimin e këtij kriteri, autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar dokumentacionin konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomik të interesuar në përmbushje të këtij kriteri, si dhe nuk ka përcaktuar kategoritë e subjekteve lëshues të këtij dokumentacioni, duke lenë vend për interpretime, si dhe duke e lënë evaziv këtë kriter, në kundërshtim me nenin 27/3 të VKM 914/2014, pasi për të provuar aftësitë dhe nivelin e ekspertizës për punonjësit elektrikist, egzistojnë disa lloje dëshmishë dhe certifikatash trajnimi, të cilat janë të niveleve të ndryshme. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të kishte përcaktuar dokumentacionin konkretë, si dhe kategoritë e subjekteve lëshues të këtij dokumentacioni, në mënyrë që të identifikohen e lehtësisht dhe që të krijohet panoramë e qartë mbi kapacitetet e kërkuara, të mos krijohet konfuzion si tek operatorët ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi, ashtu edhe tek anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave gjatë procesit të shqyrtimit e të vlerësimit të ofertave, duke mos krijuar hapësirë për vlerësim subjektiv. Vlen të theksohet se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë dhe jo diskriminues, duke



mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi, si dhe duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedurë.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.6. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilities” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Ne kriteret për kualifikim janë kërkuar edhe certifikatat ISO perkatëse për, certifikime të tilla si 9001, 18001, 39001 ETJ NUK EGZISTOJNE, vetëm sipas këtij përcaktimi të bërë nga njesia e prokurimit. Gjithashtu rezultoi se janë përcaktuar edhe ISO të pavlefshme, të cilat në datën e zhvillimit të procedurës, nuk ekzistojnë si të tilla. Në këtë mënyrë, ofertuesit nuk vihen në kushte të barabarta konkurrimi dhe vlerësimi. Lidhur me këtë pikë ankimi, AK nuk ka dhënë asnjë përgjigje pasi mbase nuk e kupton një pikë të tillë.[...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën nr.12, pika 2.3.5 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon::

*“Operatorët ekonomikë, për të vërtetuar se punët, objekt prokurimi, I plotësojnë kërkesat e cilësisë, duhet të paraqesin certifikatat të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, I akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Konkretisht:*

- 1. ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.*
  - 2. ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme.*
  - 3. OHSAS 18001/ISO 45001 (Standard për menaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme.*
  - 4. ISO 39001 (Standard për sistemin e menaxhimit të sigurisë rrugore)/ekuivalente dhe e vlefshme.*
  - 5. ISO 50001 (Standard për sistemin e menaxhimit të energjisë)/ekuivalente dhe e vlefshme.*
- Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.”*

III.6.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorhet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”.

III.6.3. Në nenin 30 të Vendimit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e

*cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 2. Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.”*

III.6.4. Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton dhe kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Në rastin konkret, për Autoritetin Kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik kryen aktivitetin objekt prokurimi sipas standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare, vërtetuar kjo nëpërmjet paraqitjes të certifikatave si ISO 9001 (Standard për Sistemin e Menaxhimi të Cilësisë)/ekuivalente dhe e vlefshme; ISO 14001 (Standard për sistemin e menaxhimit të mjedisit)/ekuivalente e vlefshme; OHSAS 18001/ISO 45001 (Standard për manaxhimin e rreziqeve rreth shëndetit dhe sigurimit në punë)/ekuivalente dhe e vlefshme; ISO 39001 (Standard për sistemin e menaxhimit të sigurisë rrugore)/ekuivalente dhe e vlefshme; ISO 50001 (Standard për sistemin e menaxhimit të energjisë)/ekuivalente dhe e vlefshme. KPP thekson se, autoriteti kontraktor duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, gëzon të drejtën për t'u garantuar se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin e vecantë të kualifikimit duke cituar kodin referues të standartit të certifikimit dhe titullin e tij., por, në citimin e kodit referues të standartit të certifikimit, autoriteti kontraktor nuk e ka përcaktuar të plotë kodin referues, pasi nuk ka cituar vitin e miratimit të standartit. Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke e përcaktuar të plotë kodin referues të standartit të certifikimit, në mënyrë që ky kriter të jetë në përputhje të plotë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për prokurimin publik.

III.6.5. Ndërsa lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes se janë përcaktuar ISO të pavlefshme në datën e zhvillimit të procedurës, nga verifikimet e kryera, rezulton se të gjithë certifikatat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të vlefshme për vitin 2020. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, përse kohë procedura e prokurimit do të zhvillohet dhe është parashikuar të realizohet plotësisht brenda vitit 2020, atëherë pretendimi i operatorit ekonomik ankimes mbi pavlefshmërinë e certifikatave të përcaktuara nga autoriteti kontraktor është i pabazuar. Nga ana tjetër, Komisioni thekson se operatori ekonomik nuk ka specifikuar se cila nga certifikatat do të jetë e pavlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Komisioni gjykon se, operatori ekonomik ankimes ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë pjesërisht.

III.7. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Mag-Utilities” sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: “[...]Ne kriteret specifike për kualifikim AK ka kërkuar edhe mostrat e mallit, po ka harruar që ne rastin konkret ju e kemi klasifikuar procedure e prokurimit pune publike, pra jo FV malli, gjë e cila është shumë e gabuar. Pra, mostrat mund të kerkohen vetëm në rastin e procedurës së prokurimit mall dhe jo për pune publike, ku një kerkese e tillë për rastin në fjalë, nuk gjen mbështetje ligjore. Lidhur me këto pike ankimi, e cila mbase nuk kuptohet nga anetaret e komisionit të shqyrtimit të ankesës, nuk është kthyer përgjigje, duke pranuar për sa është trajtuar. AK nuk kupton mbase se ku ndryshon F.V. për blerje malli me procedure pune publike, të cilat kanë DST të ndryshme, për rrjedhojë edhe kritere të ndryshme për kualifikim. Gjithashtu, AK ka bërë një përcaktim jo vetëm antiligjor, por edhe shumë të paqarte, ku një here kerkoni të paraqitet mostra brenda 5 ditëve nga kërkesa, nderkohe nuk e kuptojmë se në cilën periudhë duhet të paraqiten mostrat e pretenduara nga ana AK, si dhe sqaroni mosparaqitja e deklarates. Nderkohe që nuk kemi kërkuar asnjë deklaratë. Lidhur me këto pike konfuze për kualifikim, AK nuk ka kthyer asnjë përgjigje, pasi mbase nuk e kupton shkeljen e ligjit që ka kryer. Një here kerkon deklaratë, nderkohe në kërkesat për kualifikim nuk kerkon asnjë deklaratë. Një here kerkon brenda 5 ditëve nga kërkesa, nderkohe nuk kuptohet kush do të jetë kërkesa e tij [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën nr.12, pika 2.3.7 “Për kapacitetin teknik”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar, si më poshtë vijon: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se është I gatshëm të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktor mostrat e mallrave objekt I prokurimit, brenda pesë ditëve nga data e kërkesës për dorëzimin e tyre. Mosparaqitja e deklaratës dhe e mostrave brenda afatit të sipërcituar përbën shkak për skualifikimin nga procedura e prokurimit.”

III.7.2. Në nenin 46, pika 1 e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se : “[...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese [...]”

III.7.3. Në nenin 27 pika 6 gërma “a” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me

*kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit dhe/ose*

*b) dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike; dhe/ose*

*c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.7.4. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

III.7.5. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret K.P.P. konstaton se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton se për përmbushjen e synimit të këtij autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik (makineri, staf etj) si edhe kriteret kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimin të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon se kërkesa e mësipërme e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mostrave është në përputhje me nenin 27 pika 6 gërma "a" të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, por hartimi i kriterit duke mos përcaktuar një afat konkretë mbi ditën e paraqitjes së mostrave, e bën tepër evaziv si kriter, pasi operatorët ekonomik duhet të njihen në mënyrë të qartë me afatin e dorëzimit të mostrave, që të kryejnë përgatitjet e nevojshme. Për këtë arsye, autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të sipërcituar duke përcaktuar një afat konkretë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Mag-Utilities" sh.p.k. për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, me argumentin: "[...]Gjithashtu, nuk kuptojmë kërkesa të tilla për kualifikim, referuar zerave që kërkojnë të realizohen, ku nuk po e kuptojmë se për cilat rrugë behet fjale konkretisht, se ku do të vendoset ndricimi që ju kerkoni, sepse duam që të bëjmë edhe vete verifikimin se ku do të vendosen, që të japim një oferte sa më dinjitoze, pra duke ditur terrenin konkret.[...]", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.8.1. Në shtojcën "Specifikime teknike", të ngarkuar në SPE për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

*“Rehabilitimi i ndricimit rrugor me sistemin LED do te gjej zbatim ne te gjithë territorin e Bashkise Kavaje (qyteti Kavaje, fshati Synej, fshati Luz I Vogel, fshati Golem, fshati Helmas) ne te gjitha rruget dhe sheshet sipas planvendosjes perkatese.”*

III.8.2. Në nenin 23 pika 4 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet se :” 4. Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshatshme për mjedisin.”

III.8.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor në cilësinë e organit përgjegjës të mirëmenaxhimit të fondeve publik (në zbatim të nenit 12 të LPP-së) është njëherazi përgjegjës për ndjekjen e të gjithë hapave të procedurës së prokurimit duke përfshirë edhe hartimin e specifikimeve teknike. Në rastin konkretë, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor, gjatë hartimit të specifikimeve teknike, ka përshkruar minimumin e kërkesave që duhet të kenë produktet që kërkon të furnizohet me anë të kësaj procedure prokurimi. Por, referuar objektit të prokurimit Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë plane, vizatime, modele, makete etj., pasi në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni gjykon se nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të kontratës, kërkesat e funksionit duhet të jenë të sakta për t’u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, autoriteti kontraktor duhet të publikojë planvendosjen që disponon, në përputhje me përcaktimet e pikës 4 të nenit 23 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimes qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Mag-Utilities” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me objekt “*Rehabilitim i ndricimit rrugor me sistemin LED*”, me nr. REF-65897-07-19-2020, me fond limit 65,817,340 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 19.08.2020, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kavajë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Mag-Utilities” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 877 Protokoli, Datë 04.08.2020;**

### KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**